



RAPORT  
VJETOR

ANNUAL  
REPORT

11

# ECIM TË SIGURT PËRPARA!

1999  
Themelimi  
i SIGAL

2002  
Lider në  
tregun e  
sigurimeve

2003  
F.SH.A.N  
bëhet  
aksioneri i  
parë i huaj

2003  
Shtrirje  
në Kosovë

2005  
Sigurimet  
e Jetës


2004  
Shtrirje në  
Maqedoni

2007  
Pjesë e  
UNIQA Group  
AUSTRIA

2006  
SIGAL  
Risigurime


2012  
13 vjet  
sukses

2011  
Licensimi i  
SIGAL Life UNIQA  
Kosova  
UNIQA Life Shkup  
& Fondi i Pensioneve



GRUPI SIGAL UNIQA përbëhet tashmë nga 8 kompani (faqe 14)

SIGAL UNIQA is now a group of 8 companies (page 56)



SIGAL UNIQA ofron pensione private (faqe 15)

SIGAL UNIQA offers private pensions (page 57)




SIGAL UNIQA mundëson sigurime jete edhe në Rajon (faqe 14-15)

SIGAL UNIQA enables life insurance also in the region (page 56-57)




Vlerësohemi si një ndër kompanitë më të mira në Europën Juglindore (faqe 16)

We're awarded as one of the best companies in Southeastern Europe (page 58)



Teatri Skampa rindërtohet së sajë të dëmshpërblimit të SIGAL UNIQA (faqe 18)

We reconstructed SKAMPA Theatre (page 60)



Mbështesim zhvillimin e qëndrueshëm (faqe 20)

We support the sustainable development (page 62)



Lider të tregut edhe për vitin 2011 (faqe 26)

Market leader also in 2011 (page 68)



37 milionë euro prime (faqe 24)

37 milion euro premium (page 66)



Strategjia jonë (faqe 12)

Our strategy (page 54)

## PËRMBAJTJE

### Faqe

### CONTENTS

### Page

Harta e mbulimit	6	Coverage area	6
Fjala përshëndetëse	9	Forewords	51
Strategjia	12	Strategy	54
Aksionerët	13	Shareholders	55
Ngjarje të rëndësishme gjatë vitit 2011	14	Important events during 2011	56
Përgjegjësia kontraktuale	18	Contractual Liability	60
Përgjegjësia sociale	20	Social Responsibility	62
Stafi ynë	22	Our staff	64
Të dhëna financiare të grupit	24	Financial data	66
Raporti i Pavarur i Auditit	36	Independent Audit Report	36
Kontakte	74	Contacts	74
Struktura e Grupit	77	Group Structure	77

# 2011 HIGHLIGHTS



We lead the market for the 10th year


We established 3 new companies in Albania, Kosovo and Macedonia

We grew 8 times more than the market

We achieved 37 Million Euro premiums

“ I fuqishëm dhe i sukseshëm  
Rajonal dhe ndërkombëtar  
Partneri juaj për sigurimet ”

“ Strong and successful  
Regional and international  
Your insurance partner ”



	Volumi i Primeve 31.12.2011	Nr. i Kontratave 31.12.2011	Nr. i Degëve	Agjentë	Punonjës
Shqipëri	21,355,180	298,666	27	385	215
Kosovë	8,373,689	60,398	7	63	63
Maqedoni	7,756,528	209,176	21	121	104
<b>GRUPI</b>	<b>37,485,397</b>	<b>568,240</b>	<b>55</b>	<b>569</b>	<b>382</b>

	Premium Volume as at 31.12.2011	Contracts as at 31.12.2011	Branches	Agents	Employees
Albania	21,355,180	298,666	27	385	215
Kosova	8,373,689	60,398	7	63	63
Macedonia	7,756,529	209,176	21	121	104
<b>THE GROUP</b>	<b>37,485,397</b>	<b>568,240</b>	<b>55</b>	<b>569</b>	<b>382</b>



**Andreas Brandstetter**  
Kryetar, Bordi Mbikëqyrës i SIGAL UNIQA  
CEO, UNIQA Group Austria



**Erhard Busek**  
Anëtar, Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA



**Wolfgang Kindl**  
Anëtar, Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA  
CEO, UNIQA International



**Michael D. Granoff,**  
Kryetar, Fondi Shqiptaro-Amerikan i  
Ndërmarrjeve



**Avni Ponari**  
Anëtar, Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA  
CEO, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

## Të dashur zonja dhe zotërinj, Të dashur klientë, Të dashur partnerë biznesi,

Pas një faze rekuperimi në vitin 2010, ekonomia e Europës pati sërish pengesa për tu përballur edhe gjatë 2011-ës.

Përgjatë pjesës më të madhe të vitit financiar 2011 tregjet financiare qëndruan nën hijen e krizës së borxheve europiane. Situata në tregjet financiare tregon se suksesi iu përket atyre që zhvillojnë strategji të qarta dhe i zbatojnë këto strategji në vijimësi. Kjo është pikërisht ajo që bëjmë: ne bazohemi në aktivitet të qëndrueshëm në Austri dhe në tregjet në zhvillim në Europën Qendrore dhe Lindore. Grupi dëshiron të fokusohet në potencialin e madh që do të ofrojë ky rajon përgjatë viteve duke dyfishuar numrin e klientëve deri në vitin 2020 si dhe duke dyfishuar primet në 2,5 Miliardë Euro deri në vitin 2015. Një shembull krahasues: në vitin 1997 UNIQA kishte mbi 1 milionë klientë. Ne e kemi shumëfishuar disa herë këtë numër përgjatë 13 viteve deri në 2010-ën gjithashtu sepse ne po shtojmë vazhdimisht klientë në E.Q.L.

Këtu bëhet fjalë për një treg i cili ka mbi 300 Milionë njerëz. Ne jemi prezentë në këto vende për të shfrytëzuar këtë potencial. Kjo është arsyeja përse ne po zgjerojmë aktivitetin edhe më shumë.

Në zbatim të kësaj strategjie, SIGAL, gjatë vitit 2011, bleu një Fond Pensionesh Private në Shqipëri dhe themeloi kompani për sigurimin e jetës në Kosovë dhe Maqedoni.

Sikurse në të kaluarën, përgjatë vitit financiar 2011, SIGAL UNIQA Group Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë patën një rezultat



**Andreas BRANDSTETTER**  
CEO, UNIQA Group Austria  
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA

lehtësisht të dallueshëm brenda të gjithë Grupit. Bashkëpunimi midis SIGAL dhe UNIQA Group Austria si aksioneri më i madh i tij, ka qënë i bazuar gjithnjë tek pozicioni i SIGAL si lider i tregut si dhe tek besimi i fortë për të ardhmen pozitive ekonomike të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë.

Do doja të falenderoj veçanërisht CEO-n tonë Avni Ponari i cili përfaqëson menaxhimin e SIGAL UNIQA, të gjithë punonjësit si dhe partnerët e biznesit për përkushtimin, dedikimin dhe kontributin e madh personal për një 2011 të suksesshme dhe të kënaqshme.

**Andreas BRANDSTETTER**  
CEO, UNIQA Group Austria  
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

## Të nderuar klientë dhe aksionerë, Të dashur miq dhe partnerë,

Është një kënaqësi e veçantë të ndaj sërish me ju rezultatet financiare të këtij viti të dymbëdhjetë të aktivitetit të SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

### Rritje

Edhe gjatë vitit 2011 SIGAL UNIQA pati rritje domethënëse mbi rritjen mesatare të tregjeve në të cilat operon. Më konkretisht, volumi i primeve të grupit SIGAL UNIQA u rrit me 8.39% duke arritur në 37.48 Milionë Euro. SIGAL UNIQA në Shqipëri, e cila është lider i tregut të sigurimeve jo-jetë në Shqipëri, pati një rritje prej 6.28% të volumit të primeve ndërkohë që tregu vendas u ul me 0.43%. SIGAL Life UNIQA gjithashtu lider i tregut shqiptar të sigurimeve të jetës u rrit me 15.39%; UNIQA a.d Shkup u rrit me 12.25% kurse SIGAL UNIQA Kosova u rrit me 11.57%.

Kjo dinamikë rritjeje në të tre rajonet dhe në të gjitha segmentet e sigurimeve konfirmon sërish saktësinë dhe vizionin e strategjisë sonë në bazë të së cilës është rritja dhe stabiliteti financiar pavarësisht periudhës së vështirë në të cilën ndodhet ekonomia botërore.

### Pozicionimi në treg

Gjatë vitit 2011 SIGAL UNIQA përforcoi pozitat e veta në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Në këtë mënyrë, SIGAL UNIQA dhe SIGAL Life UNIQA vijojnë udhëheqjen e tregut shqiptar duke zotëruar përkatësisht 32.76% ( të tregut për sigurimet jo-jetë) dhe 47.95% ( të tregut për sigurimet e jetës). Aktiviteti siguroes në Kosovë dhe Maqedoni



Avni PONARI  
CEO, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA

ka qënë gjithashtu i suksesshëm pasi SIGAL UNIQA Kosova renditet e dyta në treg kurse UNIQA a.d ka përforcuar pozitën e saj duke u pozicionuar një vend më sipër në tregun maqedonas.

### Shtrirje

Viti 2011 ishte një vit i rëndësishëm edhe përsa i përket shtrirjes së mëtejshme të aktivitetit të SIGAL UNIQA. Më konkretisht, në muajin Mars u licencua Fondi i Pensioneve SIGAL Life i cili operon në tregun e pensioneve private suplementare. Aktualisht, Fondi kryeson këtë treg pasi zotëron mbi 40% të tij. Pak muaj më pas, në Maj 2011 grupit SIGAL UNIQA iu shtua edhe UNIQA Life a.d, kompani sigurimi jete e cila filloi aktivitetin në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës menjëherë pas licencimit nga Autoriteti Mbikëqyrës.

Në Shtator 2011, licencimi i SIGAL Life Kosova çoi në 8 numrin e kompanive pjesë e grupit SIGAL UNIQA. SIGAL Life UNIQA Kosova, autorizuar nga Banka Qendrore e Republikës

së Kosovës, operon në tregun kosovar të sigurimeve të jetës.

Shtrirja e aktivitetit në Kosovë dhe Maqedoni është një investim prej 7 Milion Euro falë të cilit u bë i mundur kompletimi dhe ofrimi i të gjithë gamës së sigurimeve tek klientët në rajon. Ky investim është i rëndësishëm dhe garantues për të gjithë klientët e SIGAL UNIQA pasi nga njëra anë bën të mundur ofrimin e gjithë gamës së produkteve të sigurimit dhe nga ana tjetër si kompani mirëfilli për sigurimet e jetës që ofrojnë dhe garantojnë produktet e sigurimit të jetës.

Në këtë mënyrë, në vitin 2012 SIGAL UNIQA prezantohet edhe më fuqishëm dhe me një strukturë të re organizative në të cilën përfshihen 3 kompani sigurimi jete (SIGAL Life UNIQA, UNIQA Life a.d, SIGAL Life UNIQA Kosova); 3 kompani sigurimi jo-jetë (SIGAL UNIQA, UNIQA a.d, SIGAL UNIQA Kosova); 1 fond pensione private ( Fondi i Pensioneve SIGAL Life) dhe 1 kompani risigurimi ( SIGAL UNIQA Risigurime).

### Përgjegjshmëri

Karakteristikë e SIGAL UNIQA është, ndër të tjera, kujdesi ndaj klientit dhe pagesa në kohë e dëmeve. Sikurse çdo vit, edhe gjatë 2011-ës kemi paguar shuma të mëdha dëmsh klientëve tanë që kanë siguruar jetën, shëndetin, makinën apo pasurinë. Një ndër rastet më të njohura dhe njëkohësisht ngjarje që tronditi artdashësit shqiptarë ishte djegia e Teatrit Skampa i cili ishte siguruar tek SIGAL UNIQA. Teatri u rindërtua brenda pak muajsh falë pagesës së dëmshpërblimit nga SIGAL UNIQA.

### Risi

Gjatë vitit 2011 ne vijuem me promovimin e produkteve të cilat rezultuan të suksesshme në tregun shqiptar të sigurimeve. Gjithashtu,

ne zgjeruam edhe më shumë gamën e produkteve tona përmes prezantimit të pensioneve private suplementare të cilat tashmë i ofrohen të gjithë të interesuarve që duan të kenë një pension privat shtesë krahas atij shtetëror. Ndër të tjera, e veçanta e këtij produkti është se çdokush mund të caktojë vetë vlerën e pensionit që dëshiron të marrë dhe moshën në të cilën do që të fillojë tërheqjen e këtij pensioni. Nisur nga kjo, gjithsecili ka në dorë një plan të sigurt kursimi përfitimet e të cilit do të mund t'i përdorë gjatë pleqërisë.

### Parashikimi për të ardhmen

Bordi Mbikëqyrës dhe ai Drejtues i SIGAL UNIQA, bazuar në rezultatet e mira financiare të 2011-ës mbi bazën e të cilave është ndërtuar një strategji e kujdesshme biznesi, është pozitiv për një 2012 shumë premtuese.

Duke ju falënderuar ju klientë, aksionerë dhe partnerë për mbështetjen dhe besimin e treguar dhe duke përgëzuar stafin e SIGAL UNIQA për përkushtimin, ju shpreh besimin dhe premtimin për edhe më shumë suksese në rrugën tonë të përbashkët drejt një të ardhme më të sigurt.

Avni PONARI  
CEO, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

## STRATEGJIA

### ■ Përkujdesje ndaj klientit

Shërbimi dhe produktet që ofron SIGAL UNIQA janë të një standardi të lartë, të njëjta me ato që ofrohen në tregjet ndërkombëtare të sigurimeve. Përmes tyre, asistencës 24 orë në të gjithë botën dhe pagesës së shpejtë të dëmeve, klientët e SIGAL UNIQA marrin përkujdesjen maksimale dhe përgjigje në kohë për çdo nevojë që kanë.

### ■ Partner i besueshëm

Institucione të rëndësishme financiare dhe biznese që operojnë në fusha të ndryshme janë ndër klientët dhe bashkëpunëtorët më të mëdhenj të SIGAL UNIQA të cilët kanë mundësuar mbështetje menaxheriale dhe financiare. Ndër to renditen banka, ambasada të huaja dhe ato shqiptare në botë, kompani celulare etj. SIGAL UNIQA ka ndërtuar në këtë mënyrë marrëdhënie të forta biznesi mbi bazën e besimit reciprok tek zhvillimi dhe kontributi në zhvillimin ekonomik të vendeve në të cilat operon. Por, SIGAL UNIQA është gjithashtu një partner i besueshëm për mijëra familje dhe individë të cilët kanë siguruar shëndetin, jetën dhe shtëpinë e tyre tek kompania më e madhe e sigurimeve në vend.

### ■ Investitorë të huaj

SIGAL UNIQA është kompania e parë e sigurimeve që tërhoqi investimin e huaj. Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve u bë aksioneri i parë i huaj duke blerë 13.3% të aksioneve të SIGAL në vitin 2003. Katër vjet më vonë, një ndër grupet më të fuqishme financiare në Europën Qendrore dhe Lindore, UNIQA Group AUSTRIA, vlerësuar me 'A' nga 'Standard & Poor's' bleu 45.64% të aksioneve të Kompanisë dhe aktualisht është aksioneri më

i madh i SIGAL UNIQA duke zotëruar 68.64% të aksioneve. Në këtë mënyrë, mbi 80% e aksioneve të SIGAL UNIQA janë investim i huaj i cili ka sjellë mbështetjen dhe eksperiencën e suksesshme ndërkombëtare në Shqipëri.

### ■ Produkte sigurimi të nivelit ndërkombëtar

SIGAL UNIQA është gjithnjë një hap përpara edhe përsa i përket prezantimit të produkteve inovative sigurimi. SIGAL UNIQA ka prezantuar gjithnjë produkte të reja për tregun shqiptar të sigurimeve ndër të cilat pensioni privat suplementar. Përmes këtij produkti si dhe sigurimit privat të shëndetit, sigurimit të jetës me kursim, çdokush mund të planifikojë më mirë të ardhmen e tij dhe familjes.

### ■ Rrjeti i gjerë rajonal në ballkan

Rrjeti i SIGAL UNIQA përbëhet nga rreth 900 punonjës dhe agjentë të cilët mundësojnë shërbim cilësor në të gjithë Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë. Ky rrjet mbështetet nga një rrjet ndërkombëtar i shtrirë në 21 shtete evropiane përmes 40 kompanive sigurimi të cilët janë pjesë e UNIQA Group AUSTRIA.

### ■ Lider i tregut të sigurimeve

Që prej vitit 2002, SIGAL UNIQA është lider i tregut të sigurimeve në Shqipëri duke zotëruar mbi 30% të tregut të sigurimeve të jo-jetës, jetës dhe pensioneve private si dhe e ka kryesuar atë për nga dëmet e paguara. Përgjatë viteve, SIGAL UNIQA ka pasur rritje më të madhe se rritja mesatare e tregut dhe kjo ka mundësuar përforcimin e mëtejshëm të pozitave në tregun rajonal të sigurimeve.

## AKSIONERËT




### ■ UNIQA GROUP AUSTRIA

UNIQA Group Austria është aksioneri më i madh i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA pasi zotëron 68.64% të aksioneve të Kompanisë. UNIQA është aksioner i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA që nga muaji Mars i vitit 2007.

UNIQA Group Austria është një nga grupet më të fuqishme financiare në Evropën Qendrore dhe Lindore me një shtrirje të gjerë rajonale pasi operon në 21 tregje evropiane sigurimi përmes 40 kompanive pjesë e grupit UNIQA. UNIQA Group Austria është vlerësuar nga "Standard & Poor's" me "A".

Që nga formimi i saj, UNIQA Group Austria ka përforcuar shpejt pozitat e saj në tregun e sigurimeve vendas dhe atë të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Me rreth 20 000 punonjës, 8.1 milionë klientë dhe 24.6 Miliardë Euro asete nën menaxhim, UNIQA është një nga kompanitë më energjike në Evropë.



### ■ FONDI SHQIPTARO - AMERIKAN I NDËRMARRJEVE

F.SH.A.N zotëron 13.3% të aksioneve të SIGAL dhe është aksioner i kompanisë që nga Tetori i vitit 2003.


Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve është themeluar me iniciativë dhe vendim të Kongresit Amerikan në vitin 1995 në kuadër të marrëveshjes "Për Demokracitë e Evropës Lindore". Qëllimi kryesor i F.SH.A.N është të promovojë zhvillimin e ekonomisë duke investuar në një gamë të gjerë biznesesh përmes dhënies së udhëzimeve dhe këshillave lidhur me menaxhimin.

F.SH.A.N drejtohet nga menaxherë profesionistë të investimeve që udhëhiqen nga Bordi i Drejtorëve të cilët emërohen nga Presidenti i SH.B.A-së.

68.64 % UNIQA Group Austria

13.3 % F.SH.A.N

18.06 % Investitorë vendas



## NGJARJE TË RËNDËSISHME GJATË 2011



### ■ Struktura e re organizative e Grupit SIGAL UNIQA

Viti 2011 ishte një tjetër vit i rëndësishëm për SIGAL UNIQA pasi Grupi zgjeroi edhe më shumë aktivitetin e tij në fushën e sigurimeve të jetës ( në Kosovë dhe Maqedoni) dhe në fushën e pensioneve private.

Tashmë, SIGAL UNIQA është një grup i përbërë nga 7 kompani sigurimi dhe një fond pensionesh private: SIGAL UNIQA (Jo-Jetë, Shqipëri), SIGAL Life UNIQA (Jetë, Shqipëri), SIGAL UNIQA Risigurime, SIGAL UNIQA Kosova (Jo-Jetë, Kosovë), SIGAL Life UNIQA Kosova (Jetë, Kosovë), UNIQA a.d Shkup (Jo-Jetë, Shkup), UNIQA Life a.d Shkup (Jetë, Maqedoni) dhe Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit SIGAL Life UNIQA.

Në këtë mënyrë, SIGAL UNIQA është grupi më i madh i sigurimeve në Shqipëri dhe një prej grupeve më të fuqishme në të gjithë rajonin ku operon.

### ■ UNIQA Life a.d Shkup licenohet si kompani sigurimi jete

SIGAL UNIQA ka përforcuar më tej prezencën e saj në Maqedoni përmes zgjerimit të aktivitetit edhe në fushën e sigurimeve të jetës nëpërmjet licencimit të UNIQA Life a.d Shkup.

Kjo kompani u themelua në sajë të një investimi prej 3.5 Milionë Euro. UNIQA Life a.d Shkup u licencua nga Autoriteti Mbikëqyrës në Maj 2011 pas të cilit filloi aktivitetin në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës në të cilin operojnë tashmë 5 kompani sigurimi.

SIGAL UNIQA është prezente në Maqedoni që prej vitit 2004 përmes UNIQA a.d Shkup e cila ushtron aktivitetin në tregun e sigurimeve jo-jetë.

Themelimi i UNIQA Life a.d Shkup është një konkretizim i strategjisë së kompanisë e cila konsiston në ofrimin e produkteve novative sigurimi të SIGAL UNIQA edhe në Maqedoni.



### ■ SIGAL Life UNIQA Group Austria Kosova licenohet si kompani sigurimi jete

SIGAL Life UNIQA Kosova filloi aktivitetin në tregun kosovar të sigurimeve të jetës në Shtator 2011 pas licencimit nga Banka Qëndrore e Kosovës.

Fillimi i aktivitetit të SIGAL Life UNIQA Kosova u bë i mundur falë investimit prej 3.5 Milionë Euro.

SIGAL UNIQA Kosova (Jo-Jetë) operon në tregun kosovar të sigurimeve jo-jetë që prej vitit 2003 dhe renditet e dyta në tregun vendas të sigurimeve.

Përmes licencimit të SIGAL Life UNIQA Kosova, SIGAL UNIQA ofron tashmë në Kosovë një gamë më të gjerë produkteve sigurimi në të dyja fushat: jetë dhe jo-jetë.



### ■ Fondi i Pensioneve Private SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA fillon aktivitetin

Në Mars 2011, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licencoi Shoqërinë Administruese të Fondeve të Pensionit SIGAL Life UNIQA për të operuar në tregun shqiptar të pensioneve private.

Fondi i Pensioneve Private SIGAL Life UNIQA është kompania e dytë që licenohet nga A.M.F dhe tashmë kryeson tregun e pensioneve private si për nga kontributet ashtu edhe për nga numri i kontribuuesve.

Rritja e numrit të kompanive që operojnë në tregun e pensioneve private do të luajë një rol të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të vazhdueshëm të tij dhe do të rrisë edhe më tej besimin e publikut për të investuar në fonde pensionesh private.





### ■ Vlerësime ndërkombëtare

Business Initiative Directions ka vlerësuar SIGAL UNIQA me Çmimin Ndërkombëtar të Cilësisë ('International Gold Star for Quality'). Çmimi iu akordua SIGAL UNIQA pas një analize të detajuar që B.I.D i bëri tregut shqiptar të sigurimeve bazuar në performancën e secilës prej kompanive që operojnë në këtë treg. SIGAL UNIQA u vlerësua, ndër të tjera, për shërbimin cilësor ndaj klientit, leadershipin, risitë që sjell dhe prestigjin.

Çmimi iu dorëzua Drejtorit të Përgjithshëm të SIGAL UNIQA, z. Avni Ponari nga Presidenti i B.I.D, z. Jose E. Prieto gjatë Konventës për Cilësinë e cila u organizua në Gjenevë. Çmimi i dhënë përfaqëson respektin për komunitetin në të cilin operon SIGAL UNIQA, dëgjimin e kërkesave dhe opinionit të klientëve, zhvillimin e qëndrueshëm të kompanisë dhe tarifat konkurruese.

Gjatë vitit 2011, SIGAL UNIQA u rendit sërish si një ndër kompanitë më të mira në sigurimit në rajonin e Europës Qendrore dhe Lindore. South East European News analizoi performancën e bizneseve, ndër të cilat banka dhe kompani sigurimi të cilat operojnë në këtë rajon dhe mbi këtë bazë publikoi listën e bizneseve me treguesit më të mirë. SIGAL UNIQA është kompania e vetme e sigurimeve në Shqipëri e cila u përfshi në listën e kompanive me performancën më të mirë.

### ■ Takime dhe analiza të Grupit

#### Konferenca e 10të Rajonale

Konferenca e sivjetshme Rajonale e SIGAL UNIQA u organizua në Prishtinë me pjesëmarrjen e z. Wolfgang Kindl, CEO i UNIQA International, përfaqësues të lartë të politikës dhe ekonomisë kosovare dhe staf i kompanive SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Konferenca kishte në fokus të saj performancën financiare të gjithë Grupit përgjatë gjysmës së parë të vitit, sfidat dhe problemet për tu konsideruar në gjashtëmujorin e dytë dhe prezantimin e strukturës së re organizative. Synimi i takimeve rajonale të SIGAL UNIQA është gjetja e zgjidhjeve për çështjet kryesore të Kompanisë duke analizuar gjendjen e saj dhe tendencat e secilit prej tregjeve ku operon SIGAL UNIQA.

#### Analiza Financiare e 9-mujorit

Në Nëntor 2011 u zhvillua në Ohër Analiza Financiare e 9-mujorit në të cilën morën pjesë drejtues të kompanive SIGAL UNIQA, drejtorët e departamenteve dhe të mbi 60 degëve. Gjatë takimit u analizuan arritjet e SIGAL UNIQA si dhe sfidat për pjesën e mbetur të 2011-ës. Gjatë periudhës Janar-Shtator 2011, Grupi SIGAL UNIQA pati një rritje të volumit të primeve prej 6.76% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja e vazhdueshme e SIGAL UNIQA mbi rritjen mesatare të tregjeve ku operon, përforcon pozicionin si lider i tregut dhe vërteton vizionin e qartë dhe synimin për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të tregjeve vendase.



#### Sigurimi i Shëndetit për të gjithë familjen:

- Paketa shëndetësore E ARTË-VIP mbulon shpenzimet mjekësore deri në 500,000 Euro në klinikat dhe spitalet pothuajse në të gjithë botën;
- Paketa shëndetësore E ARGJENDTË mbulon shpenzimet mjekësore deri në 150,000 Euro në klinikat dhe spitalet në Austri, Turqi, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni;
- Paketa shëndetësore STANDARD mbulon shpenzimet mjekësore deri në 30,000 -50,000 Euro në klinikat dhe spitalet më të mira private në Shqipëri.

#### Health insurance for the whole family:

- Gold Health Package covers medical expenses up to 500.000 Euro in clinics and hospitals almost all over the world;
- Silver Health Package covers medical expenses up to 150.000 Euro in clinics and hospitals in Austria, Turkey, Albania, Kosova and Macedonia;
- Standard health package covers medical expenses up to EUR 30.000 -50.000 in the best private clinics and hospitals in Albania.

## PËRGJEGJËSI KONTRAKTUALE



Teatri Skampa pas djegies totale.



Teatri Skampa pas rikonstruktimit

### ■ Teatri Skampa rindërtohet së sajë të dëmshpërblimit të SIGAL UNIQA

Që nga viti 2009, SKAMPA dhe shumë objekte të tjera të qytetit të Elbasanit janë siguruar pranë SIGAL UNIQA ashtu sikurse edhe shumë prona publike dhe private në Shqipëri dhe rajon. Më 4 Gusht 2011, Teatri Skampa u përfshi nga flakët si pasojë e të cilave u dëmtuan plotësisht skena, platea, lozhat dhe dhomat e artistëve dhe dëmet e llogaritura kapën vlerën e qindra mijëra euro. SIGAL UNIQA pas kësaj humbjeje financiare vendosi t'i kthejë vlerën artistike dhe historike qytetit. Rikonstruksioni, i cili filloi menjëherë dhe përfundoi brenda pak muajsh, u bë i mundur nga dëmshpërblimi i vlerës së dëmit të paguar nga SIGAL UNIQA. Falë këtij investimi, SKAMPA është sot teatri më modern në Shqipëri, me kushte optimale dhe akustikë edhe më të mirë. Rikonstruksioni i Teatrit Skampa ashtu sikurse edhe dhjetëra raste të tjera dëmshpërblimesh të bizneseve, pronave dhe automjeteve janë një dëshmi e vazhdueshme e përbushjes së përgjegjshmërisë kontraktuale të SIGAL UNIQA ndaj klientëve dhe partnerëve.

### ■ SIGAL UNIQA dëmshpërblen familjen e minorit

Në datë 18 Tetor 2011, Naim Shyti, një minor i cili punonte në minierën e Bulqizës, humbi jetën si pasojë e një shpërthimi të fuqishëm në pusin nr. 2, në nivelin e 16 të minierës. I ndjeri Shyti, ishte i siguruar përmes skemës së

Sigurimit nga Aksidentet Personale në punë të industrisë minerare, nga kompania për të cilën punonte e cila ka siguruar të gjithë punonjësit e saj. Në kuadër të përbushjes së përgjegjësive kontraktuale, SIGAL UNIQA, konform kushteve dhe dokumentacioneve përkatëse, dëmshpërbleu familjen e të ndjerit ashtu si edhe të gjithë minororët e tjerë që u dëmtuan në këtë aksident. Motoja kryesore e aktivitetit të SIGAL UNIQA është të mbajë dhe respektojë detyrimet kontraktuale, të mundësojë pagesën në kohë të dëmshpërblimeve për humbjet e jetës dhe dëmet materiale duke treguar në këtë mënyrë seriozitet, profesionalizëm dhe mirënjohje ndaj klientëve për besimin e treguar duke u siguruar pranë SIGAL UNIQA.

### ■ SIGAL UNIQA promovon kujdesin shëndetësor përmes bashkëpunimit me spitalet

Rrjeti i partnerëve i SIGAL UNIQA përfshin, ndër të tjera, të gjitha spitalet dhe klinikat private në Shqipëri si dhe institucionet më të mira shëndetësore në mbarë botën. Me mijëra klientë të SIGAL UNIQA, mbajtës të policave të sigurimit privat të shëndetit, përfitojnë shërbime shëndetësore në institucionet më profesionale shëndetësore në Shqipëri dhe jashtë saj dhe dëmshpërblehen nga kompania më e madhe e sigurimeve në vend. Më shumë se 10,000 njerëz kanë siguruar shëndetin e tyre dhe të familjeve të tyre tek SIGAL UNIQA duke marrë në këtë mënyrë një shërbim shëndetësor cilësor.



SIGAL UNIQA ju dëmshpërblen në rast dëmtimi të pasurisë suaj nga zjarri, shpërthimi i bombolave të gazit, tërmeti, përmytja dhe rrjedhja e tubacioneve. Siguroni apartamentin duke filluar nga 25 Euro/vit, banesën ose vilën duke filluar nga 60 Euro/vit dhe biznesin duke filluar nga 100 Euro/vit.

SIGAL UNIQA compensates you in case of property damage from fire, explosion of gas container, earthquakes, floods and pipe flow. Insure the apartment starting from 25 Euro / year, home or villa starting from 60 Euro / year and business starting from 100 Euro / year.

## PËRGJEGJËSI SOCIALE



Përgjegjësia jonë sociale është të bëjmë gjënë e duhur në mbështetje të:

### Fëmijëve

SIGAL UNIQA është sponsori zyrtar i Opti Regatta: një event ndërkombëtar i cili bashkon në Shqipëri fëmijë të fshatrave S.O.S nga Shqipëria dhe Austria. Opti Regatta përfshin shkollë verore lundrimi, vizita në vende të ndryshme historike dhe aktivitete të tjera argëtuese dhe edukative.

### Ambjentit

Ne besojmë thellësisht tek zhvillimi i qëndrueshëm dhe e kemi kthyer në një moto të aktivitetit tonë të përditshëm. Problemet mjedisore janë të shumta dhe komplekse dhe ne e shohim zgjidhjen e tyre përmes bashkëpunimit të ngushtë me institucione qeveritare, OJF dhe kontribuojmë në edukimin e publikut.

Në këtë kuadër, SIGAL UNIQA ka mbështetur vazhdimisht iniciativa dhe aktivitete ambjentaliste të cilat synojnë ndërgjegjësimin, ndryshime ligjore dhe veprime të drejtpërdrejta për mbrojtjen dhe përmirësimin e ambientit.



### Sportit

SIGAL UNIQA ka mbështetur në vijimësi projekte të cilat synojnë përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete sportive. Në këtë kuadër, SIGAL UNIQA është sponsori kryesor i disa klubeve sportive në Shqipëri dhe Kosovë të tilla si Klubi Sportiv Prishtina, Skuadra e Basketbollit për Femra Flamurtari, Federata Kombëtare e Basketbollit, garave me makina etj.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i mbështetjes që ofron SIGAL UNIQA janë ekzaminimet falas për federatat sportive në Klubin e Shëndetit SIGAL UNIQA i cili është i vetmi për nga lloji në Shqipëri.

### Kulturës

Si një kompani që promovon fuqishëm kulturën, SIGAL UNIQA ka vazhduar të mbështesë projekte të ndryshme kulturore veçanërisht të rinjve. Klubi i Artit dhe Kulturës i SIGAL UNIQA është i vetmi Klub në Shqipëri në të cilin artistë të rinj mund të promovojnë falas artin e tyre duke marrë gjithashtu të gjithë mbështetjen për të cilën kanë nevojë.



**Profesionalizmi, aftësitë dhe shërbimi cilësor janë vlerat tona kryesore!**

## STAFI YNË



SIGAL UNIQA e bazon strategjinë e saj tek rritja e shitjeve, përmirësimi i marrëdhënieve me klientët dhe menaxhimi efektiv i dëmeve. Rritja e profesionalizmit përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe politikave efektive të burimeve njerëzore është në funksion të përmbushjes së këtyre synimeve.

### Stafi ynë

Gjatë vitit 2011 stafi i SIGAL UNIQA, i punësuar në 8 kompanitë SIGAL UNIQA përbëhet nga rreth 400 punonjës dhe 500 agjentë. Ky numër shënon një rritje prej rreth 20% në krahasim me 2010-ën. Rreth 25% e tyre janë të punësuar në Drejtoritë e Përgjithshme (Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni) kurse pjesa tjetër në degë, agjensi dhe pika të tjera shitjeje. Rreth 48% e punonjësve përbëhet nga femrat dhe 52% nga meshkujt.

### Kushte optimale punësimi

Stafit të SIGAL UNIQA i mundësohet rritje dhe zhvillim profesional përmes sistemit të motivimit dhe kualifikimeve si dhe kënaqësi profesionale e cila bazohet, ndër të tjera, në paga konkurruese dhe kushte shumë të mira pune.

### Rekrutimi

Përzgjedhja e kandidatëve të duhur është hapi i parë për një staf të aftë dhe të përkushtuar i cili mundëson cilësinë maksimale të shërbimit tek klientët gjë e cila na bën kompaninë më të suksesshme të sigurimeve në rajon. Për këtë arsye, i kushtohet një rëndësi e veçantë rekrutimit përmes mbledhjes së sa më shumë aplikimeve dhe intervistave të punësimi si dhe

vlërësimit të vazhdueshëm të performancës për të identifikuar dhe motivuar njerëzit që duan të investojnë në ndërtimin e karrierës së tyre në fushën e sigurimeve.

### Trajnimi i vazhdueshëm

Për rritjen e efikasitetit çdo departament shitje në bashkëpunim me departamentin e burimeve njerëzore, nën mbikëqyrjen e Bordit Drejtues përcaktojnë stafin e nevojshëm për tu trajnuar, temat e trajnimit dhe objektivat që secili prej trajnimeve duhet të përmbushë. Ciklet e trajnimeve kanë në thelb konceptet kyçe të industrisë së sigurimeve, produktet e sigurimit, procedurën e marrjes në sigurim dhe procedurat e trajtimit të dëmeve.

### Motivimi

Sistemi i motivimit që SIGAL UNIQA aplikon bazohet tek mundësitë konkrete për ngritje profesionale, incentivat, trajnimet dhe një sistem shumë funksional bonusesh. Në këtë mënyrë, SIGAL UNIQA kujdeset që çdo punonjës të ketë motivimin dhe shtysën e duhur për të ecur suksesshëm në rrugën e tyre të karrierës si pjesë e kompanisë më të madhe të sigurimeve.

### Akademia e Menaxherëve

Akademia e Menaxherëve është një program trajnimi i UNIQA Group AUSTRIA i cili synon përmirësimin e ekspertizës strategjike të drejtuesve dhe rritjen e efikasitetit përmes kombinimit të trajnimit me eksperiencën të ndryshme që vijnë nga të gjithë kompanitë e Grupit të cilat operojnë në 21 shtete evropiane.



### Mirëserdhët në Shqipëri!

Në çdo pikë kufitare, pajisuni me policën Kufitare dhe mbroni veten dhe të tjerët nga përgjegjësitë financiare. SIGAL paguan menjëherë dëmet e ndodhura.  
Nëse dëshironi të siguroheni ka vetëm 1 emër...




### Welcome to Albania!

At each border agency, purchase Border Contract and protect yourself and others from financial responsibilities. SIGAL pays immediately the damages incurred.  
If you want to make sure there is only 1 name ...

## GRUPI

## ■ Vëllimi i primeve për vitin 2011 (në Euro)

	2009	2010	2011
<b>GRUPI</b>	<b>32,093,698</b>	<b>34,082,806</b>	<b>37,485,397</b>
Shqipëri (Jo Jetë, Jetë, Risigurime & SH.A.F.P)	19,113,993	19,860,863	21,355,180
Kosovë (Jo Jetë dhe Jetë)	7,060,838	7,501,594	8,373,689
Maqedoni (Jo Jetë dhe Jetë)	5,918,867	6,720,349	7,756,528



Për të gjithë të siguarit nga aksidentet, SIGAL UNIQA mundëson kompesim financiar në rast aksidenti në punë si pasojë e të cilit rezulton paaftësi e përkohshme ose e përhershme. Zgjidhni vetë masën e dëmshpërblimit në varësi të primit të sigurimit që ju paguani. Për informacion të mëtejshëm drejtohuni në të gjitha zyrat e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA.

For all insured from accidents, SIGAL UNIQA enables financial compensation in case of injury that causes temporary or permanent disability. Choose yourself the amount of compensation depending on the insurance premium you pay. For further information contact SIGAL UNIQA Group AUSTRIA offices.


## SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Shqipëri Jo - Jetë

### Tregu shqiptar i sigurimeve të jo - jetës

Sipas raportit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjatë vitit 2011 në tregun shqiptar të sigurimeve të jo-jetës kanë ushtruar aktivitetin e tyre 8 kompani.

Tregu është udhëhequr nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Jo-jetë Shqipëri me 32.76 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve.

32.76 % SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Jo - Jetë





### Dëme të paguara për vitin 2011

Sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në tregun shqiptar të sigurimeve jo-jetë janë paguar rreth 2.07 Miliardë lekë dëme nga të cilat 32.34 % janë paguar nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Jo-Jetë.

### Të ardhura vjetore nga primet SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Jo Jetë Shqipëri (në Euro)

	2009	2010	2011
<b>TOTAL</b>	<b>16,205,254</b>	<b>16,651,297</b>	<b>17,001,908</b>
AP dhe Shëndet	990,453	1,427,787	2,098,250
Motorike	9,102,049	9,140,688	8,420,395
Marinë dhe Aviacion	1,970,943	1,690,626	1,364,083
Pasuri dhe Përgjegjësi	3,472,248	3,932,214	4,644,986
Garanci	669,561	459,981	474,194



#### SOT PËR NESËR

Pension privat i kombinuar me sigurimin e jetës. Përcaktoni ju moshën dhe vlerën e pensionit që doni të merrni:

#### TODAY FOR THE FUTURE

Private pension combined with life insurance. You can determine the age and value of pension that you want to benefit:


Kontributi për 15 vjet Contribution for 15 years	Shuma e siguruar Insured Sum	Pensioni që përfitohet ( për 10 vjet) Benefited Pension (for 10 years)
130 Euro/muaj (month)	23,024 Euro	229 Euro/muaj (month)
200 Euro/muaj (month)	35,422 Euro	352 Euro/muaj (month)

## SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA

### Tregu shqiptar i sigurimeve të jetës

Bazuar në të dhënat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA ka qenë sërish lider i tregut të sigurimeve të jetës në të cilin operojnë 3 kompani.

SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA ka udhëhequr këtë treg me 47.95 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve.




### Dëme të paguara për vitin 2011

Sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës janë paguar rreth 88.2 Milionë lekë dëme, nga të cilat 64.81 % janë paguar nga SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA.

### Të ardhura vjetore nga primet SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA (në Euro)

	2009	2010	2011
<b>TOTAL</b>	<b>3,008,739</b>	<b>3,209,566</b>	<b>3,645,281</b>
Sigurimi i Jetës për Hua	2,359,245	2,409,038	2,773,934
Sigurim i Kombinuar i Jetës	103,181	110,953	152,407
Sigurimi i Jetës me Kursim	546,313	689,575	718,940



#### Sigurimi i vetë mjetit motorik

Dëmtimet aksidentale, thyerja e xhamave, fatkeqësitë natyrore, zjarri, vjedhja dhe tentativat për vjedhje, shërbim me karroatrec deri në servisën më të afërt, dëmtimet në parking, dëmtimet nga aktet keqdashëse, automjet tjetër në dispozicion gjatë kohës së riparimit të mjetit të siguruar.

#### Motor Insurance

Accidental damages, windows breaking, natural disasters, fire, theft and attempted theft, tow truck service to the nearest servicing, parking damages, damages from malicious acts, another vehicle available during the repair of the insured vehicle.


## SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Jo Jetë Kosova

### Tregu kosovar i sigurimeve

Bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2011 në tregun kosovar të sigurimeve të jo-jetës kanë ushtruar aktivitetin e tyre 10 kompani sigurimi jo-jetë.

Gjatë vitit 2011 SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova u pozicionua e dyta në treg duke zotëruar 12.76% të tij për primet e shkruara.

12.76 % SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova




### Dëme të paguara për vitin 2011

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, në tregun kosovar të sigurimeve jo-jetë janë paguar rreth 22.6 Milionë Euro dëme, nga të cilat 9 % janë paguar nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova.

### Të ardhura vjetore nga primet SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova (në Euro)

	2009	2010	2011
<b>TOTAL</b>	<b>7,060,838</b>	<b>7,501,594</b>	<b>8,368,689</b>
AP dhe Shëndet	593,410	828,349	1,043,981
Motorike	5,403,751	5,640,163	6,110,956
Marinë dhe Aviacion	13,809	16,975	31,570
Pasuri dhe Përgjegjësi	641,902	795,071	872,024
Garanci	407,966	221,036	310,157



